



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:006982

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06458817

C.nr. 1673/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëseve J.M nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit dhe V.Th nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokati R.H nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike për kompensim nga marrëdhënia e punës, vlera e objektit të kontestit 1,264.8 euro, jashtë seancës, më datën 15.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëseve J.M dhe V.Th.
- II. DETYROHET paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses J.M, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 29.09.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 220 ditë pune të ja paguajë shumën prej 440,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, po ashtu në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 29.09.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 220, ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 2 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 1,40 euro të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 308.00 euro, apo shumën e përgjithshme, prej 748.00 euro me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses V.Th, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 24.02.2022 e deri më datën 21.11.2022 për 152 ditë pune të ja paguajë shumën prej 304,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, po ashtu në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit

për periudhën kohore prej datës 24.02.2022 e deri më datën 21.11.2022 për 152, ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 2 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 1.40 euro të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 212.8 euro, apo shumën e përgjithshme, prej 516.80 euro me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.

- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëseve J.M dhe V.Th, t’i paguajë shumën prej 177,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset J.M dhe V.Th përmes avokatit të tyre të autorizuar, më datën 29.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit të shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit.

Të njëjtat sipas padisë kanë theksuar se janë në mardhënie pune pranë SHFMU “Rilindja” si mësimdhënëse në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditëseve nga data 12.04.2022 e deri me datën 21.11.2022 i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe udhëtim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk janë kompensuar.

Përfaqësuesi i autorizuar përmes parashtrësës me datën 27.09.2024 ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë. Në precizimin është kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 29.09.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për paditësen J.M për 220 ditë të prezencës në punë si dhe për paditësen V.Th për 152 ditë të prezencës në punë, vlera e kontestit 1,264.8 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 14.08.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se paditësit nuk kanë dorëzuar asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe me të cilat do të vërtetonin faktet e paraqitura në padi. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave, për paditësen J.M: kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit

0107, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë i datës 07.12.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit shtator 2024, i lëshuar nga Tnë Prizren për paditësen J.M.

Për paditësen V.Th, kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 04/232, e datës 06.05.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë i datës 07.12.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit dhjetor 2023, i lëshuar nga T në Prizren për paditësen V.Th.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditëset kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditëset për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëseve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, a i takon kompensimi për shpenzimet e udhëtimit si dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 0107, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses J.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë i datës 07.12.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja J.M, në periudhën kohore prej datës 29.09.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 220 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit shtator 2024, i lëshuar nga T në Prizren për paditësen J.M, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Dejnë-Çifllak si dhe anasjelltas është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 04/232, e datës 06.05.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.Th, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë i datës 07.12.2023, i lëshuar nga SHFMU “Rilindja” në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.Th, në periudhën kohore prej datës 24.02.2022 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 152 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit të çmimit të biletës së udhëtimit i muajit tetor 2023, i lëshuar nga Tnë Prizren për paditësen V.Th, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Mrasor-Çifllak si dhe anasjelltas është 2 euro në dy drejtime.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses për faktin se paditësja J.M në periudhën kohore nga data 29.09.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin saj të punës kanë prezantuar 220 ditë të punës dhe paditësja V.Th në periudhën kohore nga data 24.02.2022 e deri më 21.11.2022, në vendin saj të punës kanë prezantuar 152 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësja ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”* Për paditësen J.M në rast se shumëzohen 220 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 440.00 euro, për paditësen V.Th në rast se shumëzohen 152 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 304.00 euro.

Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Për paditësen J.M në rast se shumëzohen 220 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1,40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 308 euro, për paditësen V.Th në rast se shumëzohen 152 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1,40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 212.80 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 177,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 156.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1673/2023, më datën 15.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.